11	Aroma Sylhasi, Besim Ajvazi	Comparative analysis between the land consolidation guide and current legislation in Kosovo	<a href="mailto:aroma.sylhasi@student.uni-pr.edu">aroma.sylhasi@student.uni-pr.edu</a>
12	Borana Kulolli, Abir Gallala, Valerija Ajkoviq	Enhancing Dike Resilience: Reinforcement techniques and advanced monitoring systems for Climate Change Adaptation	<a href="mailto:Borana.Kullolli@arcelormittal.com">Borana.Kullolli@arcelormittal.com</a>
13	Otjela Lubonja, Igli Kondi, Driton Kryeziu	Comparative analysis of housing design standards in Albania, Kosovo and the EU countries	<a href="mailto:otjela.lubonja@uet.edu.al">otjela.lubonja@uet.edu.al</a>
14	Florim Grajcevc, Armend Mujaj, Valon Veseli, Dren Tahiri	Geometric Shear Wall Changes during construction on the Highrise Buildings	<a href="mailto:dren.tahiri1@student.uni-pr.edu">dren.tahiri1@student.uni-pr.edu</a>
15	Liron Morina, Rina Peja	Integrating Interpretable Machine Learning and Adaptive Sampling for Nonlinear Dynamic System Modeling	<a href="mailto:liron.morina@uni-pr.edu">liron.morina@uni-pr.edu</a>
16	Adrian Kadiri, Mario Bačić, Kemal Edip	Evaluating Differences in Predicted Settlements: A Comparative Analysis of Soil-Structure Interaction Models	<a href="mailto:adrian.kadiri@uni-pr.edu">adrian.kadiri@uni-pr.edu</a>
17	Hajdar Sadiku, Fidan Salihu, Milot Muhaxheri, Durim Sadiku	Rheological Characteristics of Hybrid Steel- Synthetic Fibers Reinforced Concrete Beams	<a href="mailto:fidan.salihu@uni-pr.edu">fidan.salihu@uni-pr.edu</a>
18	Fatos Tahiri, F. Grajcevc, Sh. Makolli	ULPIANA NEIGHBORHOOD CASE STUDY: URBAN SEISMIC RISK ASSESSMENT	<a href="mailto:fatos@premium-eng.com">fatos@premium-eng.com</a>
19	Fatos Tahiri, F. Grajcevc, Sh. Makolli	Use of Nonlinear Static And Dynamic Analysis In Evaluating Structural Performance	<a href="mailto:fatos@premium-eng.com">fatos@premium-eng.com</a>

20	Borana Kulloli, Pablo Cuellar, Matthias Baessler	Optimizing Soil-Structure Interaction for Offshore Wind Turbines: Experimental Insights and Numerical Modeling	<a href="mailto:Borana.Kulloli@arcelormittal.com">Borana.Kulloli@arcelormittal.com</a>
21	Festina Sadiku	Using GIS Applications to Create a 3D Model for a Selected Prishtina Municipality Area	<a href="mailto:festina.sadiku@uni-pr.edu">festina.sadiku@uni-pr.edu</a>
22	Festina Sadiku	Communicating the spatialization of textual descriptions of landscape changes using the storytelling approach in a 3D environment	<a href="mailto:festina.sadiku@uni-pr.edu">festina.sadiku@uni-pr.edu</a>
23	Arion Baqaj, Valbon Bytyqi	Watershed prioritization of Lumbardhi i Deçanit river basin, based on morphometric parameters and land use/land cover change	<a href="mailto:arionbaqaj@hotmail.co.uk">arionbaqaj@hotmail.co.uk</a>
24	Laurent Hakaj, Ilir Canaj, Labeat Misini	Seismic Performance and Structural Integrity Evaluation of an Existing Building	<a href="mailto:laurent.hakaj123@gmail.com">laurent.hakaj123@gmail.com</a>
25	Isak Idrizi	Using 'DASISedu' program for seismic response history analysis of 2D frame structures with different seismic protection systems	<a href="mailto:isak.idrizi@unt.edu.mk">isak.idrizi@unt.edu.mk</a>
26	Maliq Pireci, Besim Veselaj, Afrim Berisha, Isa Elshani	Greenhouse gas emissions in Municipality Rahovec and necessary measures to achieve Net Zero emissions by 2050	<a href="mailto:maliq.pireci@hotmail.com">maliq.pireci@hotmail.com</a>
27	Naser Kabashi, Fjolla Trepça, Leonit Totaj, Vesa Ademaj	Local scour around bridge piers –case study ura e zogut	<a href="mailto:leonit.totaj@student.uni-pr.edu">leonit.totaj@student.uni-pr.edu</a>
28	Arlinda Cakaj, Marta Lisiak-Zielińska, Kinga Drzewiecka, Anna Budka, Klaudia Borowiak, Maria Drapikowska, Arbnore Cakaj	Impact of Urban Land Use on Atmospheric Microplastic Deposition in Pristina, Kosovo	<a href="mailto:cakajarlinda@gmail.com">cakajarlinda@gmail.com</a>
29	Florim Grajçevci , Valon Veseli, Labeat Misini, Ilir Canaj	Structural behavior of masonry-infilled RC frames under axial and lateral loading	<a href="mailto:valon.veseli@uni-pr.edu">valon.veseli@uni-pr.edu</a>
30	Syle Berisha, Valon Veseli, Guxim Rudhani, Shkumbin Makolli	Artificial intelligence (AI) in civil engineering – A case study on perception and application	<a href="mailto:valon.veseli@uni-pr.edu">valon.veseli@uni-pr.edu</a>
31	Premton Thaqi, Drlon Begaj, Figene Ahmedi	Assessment of Rainfall Contribution to the Water Level Changes of Mirusha Lake	<a href="mailto:premtion.thaqi@uni-pr.edu">premtion.thaqi@uni-pr.edu</a>
32	Labeat Misini, Florim Grajçevci, Ilir Canaj, Valon Veseli	A targeted seismic upgrading method for precast roof beam-column connections using adaptable seismic safety key devices	<a href="mailto:labeat.misini@uni-pr.edu">labeat.misini@uni-pr.edu</a>
33	Hana Shehu Agani, Lavdim Osmanaj	Hydrological and Morphological Assessment of the Desivojçë Dam Site: A Case Study from Eastern Kosovo	<a href="mailto:hana.shehu@uni-pr.edu">hana.shehu@uni-pr.edu</a>
34	Zijadin Guri, Ilir Canaj	Nonlinear Dynamic Analysis of RC Bridges with Steel and GFRP-Reinforced Piers Calibrated Using Experimental Results	<a href="mailto:zijadin.guri@uni-pr.edu">zijadin.guri@uni-pr.edu</a>
35	Ilir Canaj, Kristina Milkova, Elena Dumova	Probabilistic Seismic Vulnerability Assessment Using Fragility Functions and Maximum Likelihood Estimation	<a href="mailto:ilir.canaj@uni-pr.edu">ilir.canaj@uni-pr.edu</a>
36	Ilir Canaj, Zijadin Guri, Labeat Misini, Valon Veseli	Seismic Analysis of Infilled RC Frames with Irregular Wall Distribution Using Macro-Modeling Techniques	<a href="mailto:ilir.canaj@uni-pr.edu">ilir.canaj@uni-pr.edu</a>
37	Armend Mujaj, Florim Grajçevci, Zijadin Guri, Elfrida Shehu, Driton Kryeziu	Experimental and Numerical Performance Analysis of Steel Scaffolding Systems with Height of 300cm	<a href="mailto:armend.mujaj@uni-pr.edu">armend.mujaj@uni-pr.edu</a>
38	Tomasz Garbowski, Anna Szymczak-Graczyk, Zijadin Guri, Ilir Canaj	Analytical Computation of the Shear Correction Factor in Layered and Heterogeneous Sections	<a href="mailto:tomasz.garbowski@up.poznan.pl">tomasz.garbowski@up.poznan.pl</a>
39	Anna Szymczak-Graczyk, Tomasz Garbowski, Florim Grajçevci , Hajdar Sadiku	Static analysis of a tilted sinking well in the context of safe operation	<a href="mailto:tomasz.garbowski@up.poznan.pl">tomasz.garbowski@up.poznan.pl</a>
40	Ibrahim Ajupi, Toni Arangelovski, Zijadin Guri, Ilir Canaj	Flexural Behavior of Reinforced Concrete Beams Retrofitted with Fiber- Reinforced Polymer (FRP)	<a href="mailto:ibrahimajupi@gmail.com">ibrahimajupi@gmail.com</a>
41	Alush Shala, Jelena Bleiziffer, Florim Grajçevci	Anchorage Techniques for Vertical Structural Continuities and the Impact of Defects on Joint Performance	<a href="mailto:alushala@gmail.com">alushala@gmail.com</a>
42	Alban Hysomemaj, Ornela Şen	Design of RC structures with Torsion Dominant Vibration Mode using Displacement Based Design	<a href="mailto:ornela_sen@universitetipolis.edu.al">ornela_sen@universitetipolis.edu.al</a>
43	Magdalena Gajewska, Katarzyna Kolečka, Magda Kasprzyk, Grażyna Gałęzowska, Alicja Kupczyk	APPLICATION OF NATURE-BASED SOLUTIONS IN URBAN ENVIRONMENT, CASE STUDIES	<a href="mailto:mgaj@pg.edu.pl">mgaj@pg.edu.pl</a>

44	Trajche ZAFIROV, Viktor HRISTOVSKI, Florim GRAJÇEVCI, Labeat MISINI	SEISMIC PERFORMANCE AND BEHAVIOR FACTOR EVALUATION OF DIFFERENT TYPES OF VERTICAL EXTENSIONS ON RC STRUCTURES	<a href="mailto:labeat.misini@uni-pr.edu">labeat.misini@uni-pr.edu</a>
45	Almedina Rapuca	Photogrammetric Documentation and 3D Modeling of the &quot;Goddess on the Throne&quot; Using Low-Cost Techniques	<a href="mailto:almedina.rapuca@uni-pr.edu">almedina.rapuca@uni-pr.edu</a>
46	Bashkim Idrizi	Length Differences between Topography, Geoid, Ellipsoid and Map Projection at KosovaRef01 plan coordinate referent system	<a href="mailto:bashkim.idrizi@uni-pr.edu">bashkim.idrizi@uni-pr.edu</a>
47	Tomasz Tymiński, Tomasz Katuża	Determination of the flow resistance force for flexible floodpl ain vegetation	<a href="mailto:tomasz.tyminski@upwr.edu.pl">tomasz.tyminski@upwr.edu.pl</a>
48	Tomasz Tymiński	Hydraulic research of water damming by flow through floodplain vegetation	<a href="mailto:tomasz.tyminski@upwr.edu.pl">tomasz.tyminski@upwr.edu.pl</a>
49	Tomasz Tymiński	Laboratory studies on the sedimentation of river debris in a fish ladder	<a href="mailto:tomasz.tyminski@upwr.edu.pl">tomasz.tyminski@upwr.edu.pl</a>
50	Guxim Rrudhani, Josif Josifovski, Armend Mujaj, Fidan Salihu	Pile analysis as geothermally active structural elements	<a href="mailto:guxim.rrudhani@uni-pr.edu">guxim.rrudhani@uni-pr.edu</a>
51	Cene Krasniqi, Markel Baballëku, Enes Krasniqi, Milot Muhaxheri, Ylli Murati	(Experimental and Numerical Study on the Structural Behavior of Various RC Slab Systems)	<a href="mailto:cene.krasniqi@uni-pr.edu">cene.krasniqi@uni-pr.edu</a>
52	Karolina Jóźwiakowska, Krzysztof Jóźwiakowski	Greener Drying: constructed wetland beds for sustainable sewage sludge dewatering	<a href="mailto:karolina.jozwiakowska@up.lublin.pl">karolina.jozwiakowska@up.lublin.pl</a>
53	Arton D. Dautaj, Markel Baballeku, Ali Sh. Muriqi	Simplified numerical method validated by experimental test for vertically hollow clay block in reinforced concrete frame under seismic loading	<a href="mailto:arton.dautaj@uni-pr.edu">arton.dautaj@uni-pr.edu</a>
54	Alfred Lako, Mikael Lako	Fundamental Principles of Biogas Product	<a href="mailto:alfredlako@yahoo.com">alfredlako@yahoo.com</a>
55	Alfred Lako, Mikael Lako	Landfill Gas Generation and Emission Models Model Options for Recovery System Design and Greenhouse Gas Inventories	<a href="mailto:alfredlako@yahoo.com">alfredlako@yahoo.com</a>
56	Kuenda Laze	A descriptive analysis of plant, shrub and tree species identified on land and coastland, Southeastern Europe	<a href="mailto:kuenda.laze@fin.edu.al">kuenda.laze@fin.edu.al</a>
57	Enkeleda Sopaj	Assessing Air Quality and Environmental Management in Civil Engineering Projects: A Case Study of the Durres- Prishtina Railway Infrastructure.	<a href="mailto:sopaj.enkeleda@gmail.com">sopaj.enkeleda@gmail.com</a>
58	Elvis Capo, Igli Kondi, Feti Selmani	The calculation of reinforced concrete elements under the action of shear force, according to Eurocodes and US code ACI 318	<a href="mailto:capo.elvi@gmail.com">capo.elvi@gmail.com</a>
59	Blerina Beqaj, Era Fusha	Exploring Hydrokinetic Power: Opportunities for Albania's Energy Transition	<a href="mailto:era.fusha@fin.edu.al">era.fusha@fin.edu.al</a>
60	Pietro BELBA, Jorgaq THANAS	The application of remote sensing techniques to identify land subsidence in Albania	<a href="mailto:pietro.belba@fgim.edu.al">pietro.belba@fgim.edu.al</a>
61	Nikolla Nika, Erdal Emre Çeçen	Adaptive Reuse of Industrial Buildings: Structural Assessment and Rehabilitation	<a href="mailto:ececen@umt.edu.al">ececen@umt.edu.al</a>
62	Jera Xhelilaj, Dr. Entela Çobani, Brisilda Rezvani, Xhuana Skura	Sustainability of Oxygenation Technologies Integrated into Drip Irrigation Systems Case study: South-eastern Spain and South Western Albania	<a href="mailto:jeraaa.xh@gmail.com">jeraaa.xh@gmail.com</a>
63	Erdal Emre Çeçen, Ergys Çaushi	Comparative Evaluation of Stone Column Performances in Soil Improvement	<a href="mailto:ececen@umt.edu.al">ececen@umt.edu.al</a>
64	Kevin PEPPPO, Arduen KARAGJOZI, Xhemi JAUPAJ (VELÇANI)	Assessment of Hydromorphological Elements in the Ishëm, Erzen, and Mat River Basins	<a href="mailto:peppokevin@gmail.com">peppokevin@gmail.com</a>
65	Xhemi JAUPAJ (VELÇANI)	Water Resources Management in the Ishem, Erzen and Mat River Basins	<a href="mailto:xhvelcani@gmail.com">xhvelcani@gmail.com</a>
66	Endri Duro, Filippo Forlani	Reliability Analysis of the Axial Bearing Capacity of pile foundations using Monte Carlo simulation	<a href="mailto:endriduro@gmail.com">endriduro@gmail.com</a>
67	Entela ÇOBANI, Sindi Alliu	Motile algae motility and their environmental application	<a href="mailto:sindi.alliu@fin.edu.al">sindi.alliu@fin.edu.al</a>
68	Esmeralda HALO, Aurel NURO, Eng. Enkelejda GJINALI	Levels of Priority Substances in the Port Area Of Porto- Romano	<a href="mailto:esmeraldahalo647@gmail.com">esmeraldahalo647@gmail.com</a>
69	Oltion Fejzollari, Igli Kondi, Julian Kasharaj	Comparative Analysis of Soil Liquefaction Potential in the Kune Vain Area (Lezhë)	<a href="mailto:fejzollari24@gmail.com">fejzollari24@gmail.com</a>
70	Erta Kushta	Application of Geodetic Technologies in the preservation of Butrint Archeologic Site	<a href="mailto:ertakushta23@gmail.com">ertakushta23@gmail.com</a>

71	Teida Shehi, Enkelejda Gjinali, Kristjana Omeri	A view of carbon market policies and implementation practices and assessment of opportunities for alignment in the Albanian context	<a href="mailto:teida.shehi@gmail.com">teida.shehi@gmail.com</a>
72	Iralda Xhaferaj	Heavy- duty pavements design methodologies for port, airports and highways	<a href="mailto:iralda.xhaferaj@fin.edu.al">iralda.xhaferaj@fin.edu.al</a>
73	Mirel MIÇO	The impact of (humidex) on the calculation of cooling degree days	<a href="mailto:mmico818@hotmail.com">mmico818@hotmail.com</a>
74	Aleks Dani, Kelti Bebeçi	The use of GIS technologies for urban development: building a digital map of the city of Kamza	<a href="mailto:aleks.dani@fin.edu.al">aleks.dani@fin.edu.al</a>
75	Ervin Stena, Anduel Alla	Development of a WebGIS platform for public access to NSDI and property data management	<a href="mailto:anduel.alla@fin.edu.al">anduel.alla@fin.edu.al</a>
76	Ervin Stena	Spatial analysis of the dynamics of the Vjosa river	<a href="mailto:ervin.stena@fin.edu.al">ervin.stena@fin.edu.al</a>
77	Oltion Marko, Joana Gjipalaj	Analysis of Multi-Criteria Evaluation Method of Landfill Site Selection in Dibra Region, Albania	<a href="mailto:oltion.marko@fin.edu.al">oltion.marko@fin.edu.al</a>
78	Orgest Shehi, Oltion Marko, Joana Gjipalaj	Application of 'Digital Twin' Technology in Wastewater Treatment: Enhancing Efficiency and Sustainability	<a href="mailto:orgest.shehi@fin.edu.al">orgest.shehi@fin.edu.al</a>
79	Sandër KOVAÇI, Eng. Migen DUKA, Luan Arapi, Dr.Monika HOXHAJ	Assessment of oil pollution in surface and groundwater through Geostatistical Methods, the case of Gjanica River basin in Fier.	<a href="mailto:dukamigen@gmail.com">dukamigen@gmail.com</a>
80	Bajame Zdrava, Elita Ferati	Hydromorphological and Hydrological Analysis of the Osum Basin in Albania	<a href="mailto:bajamezdrava@hotmail.com">bajamezdrava@hotmail.com</a>
81	Izet Mehmetaj, Diana Bardhi	Cost-Benefit Analysis of Seismic Retrofitting for Mid-Rise Buildings in Albania and the Balkan Region	<a href="mailto:dbardhi@umt.edu.al">dbardhi@umt.edu.al</a>
82	Anjeza Dulaj (Gjini), Dr.Drilon Disha, Msc.Xhuliana Gjojdeshi	Analysis on the financial effects in the field of construction, of the implementation of the technical pricing manual in Albania and comparison with the methodology used in Kosovo.	<a href="mailto:drilonadisha@yahoo.com">drilonadisha@yahoo.com</a>
83	Mentor Balilaj, Xhevahir Aliu, Gridi Pergjergji	Evaluation of Seismic Vulnerability Assessment for a Masonry Structure	<a href="mailto:mbalilaj2002@yahoo.it">mbalilaj2002@yahoo.it</a>
84	Xhevahir Aliu, Mentor Balili, Gridi Pergjergji.	Evaluation of the Seismic Response of Masonry Structure	<a href="mailto:xhevahir_aliu@yahoo.it">xhevahir_aliu@yahoo.it</a>
85	Entela Çobani , Xhuana Xhika , Denisa Selimi	An Overview of Water Footprint Assessment of Olive Oil Production	<a href="mailto:xhikaxhuana03@gmail.com">xhikaxhuana03@gmail.com</a>
86	Irsa Karaj, Klaidi Nika	Analysis of Lateral Loading on Pile Groups	<a href="mailto:irsa.karaj1@gmail.com">irsa.karaj1@gmail.com</a>
87	Drilona Disha (Karaj), Anjeza Dulaj (Gjini)	A comparison study between beams reinforced with conventional steel and cfrp bars	<a href="mailto:drilonadisha@yahoo.com">drilonadisha@yahoo.com</a>
88	Neritan Shkodrani, Marin Malotaj, Irsa Karaj	Evaluation of Pile Bearing Capacity Based on In-Situ Data from CPTu and SPT	<a href="mailto:irsa.karaj1@gmail.com">irsa.karaj1@gmail.com</a>
89	Neritan Shkodrani, Fjona Ferati, Besmira Bushaj	Theoretical Application of Wick Drains: A Case Study from Durrës	<a href="mailto:fjona.ferati@gmail.com">fjona.ferati@gmail.com</a>
90	Alketa Ndoj, Neritan Shkodrani, Shpresa Gashi	Parametric Study for Mechanically Stabilized Earth (MSE) wall	<a href="mailto:alketandoj@yahoo.com">alketandoj@yahoo.com</a>
91	Santino Spahiu, Enkelejda Gjinali	Discharge Rating Curve Estimation for Drini i Bardhë River using a Bayesian Hierarchical Model	<a href="mailto:santinospahiu@gmail.com">santinospahiu@gmail.com</a>
92	Shpresa Gashi, Neritan SHkodrani, Alketa Ndoj	Analytical and Numerical Estimation of Pile Capacity in Soft Soils: A Comparative Study Using Classical Methods and Plaxis	<a href="mailto:sgashi15@yahoo.com">sgashi15@yahoo.com</a>
93	Kristjana OMERI, Teida SHEHI	End-of-Life Photovoltaic Panels in Coastal Albania: A Case Study on Circular Economy Potential in Dhërmi	<a href="mailto:kristjanaomeri@gmail.com">kristjanaomeri@gmail.com</a>
94	Konalsi GJOKA, Aida Lahi, Kleant SEMEMA	Environmental Sustainability Through Circular Economy - Bridging Academia, Businesses and Government.	<a href="mailto:konalsigjoka@upt.al">konalsigjoka@upt.al</a>
95	Nikolla Nika	Guardrails as fundamental elements of road infrastructure	<a href="mailto:nikollanika@gmail.com">nikollanika@gmail.com</a>
96	Raimonda Dervishi, Arian Lako, Agbata Benedict Celestine, Marin Malotaj	Challenges in the Transportation Sector in Albania During the Last Decade and Future Remediations	<a href="mailto:raimondadervishi@yahoo.com">raimondadervishi@yahoo.com</a>
97	M.Hysenlliu, A.Bidaj ,	Strengthening of Earthquake-Damaged Masonry Buildings with Beam-Column Frame Interventions.	<a href="mailto:mariohysenlliu@yahoo.com">mariohysenlliu@yahoo.com</a>
98	Miriam Ndini, Miranda Deda, Liljana Lata	Climate Variability and Its Impact on Flood Risk in the Vjosa River Basin: An Analysis of Precipitation Trends and Vulnerability	<a href="mailto:mdndini@epoka.edu.al">mdndini@epoka.edu.al</a>
99	Valon Marku, Arben Dervishaj, Bledar Kalemi	Influence of ductility class on seismic performance and construction costs of reinforced concrete structures.	<a href="mailto:bledar_kalemi@yahoo.com">bledar_kalemi@yahoo.com</a>


100	Igli Kondi, Elvis Capó, Driton Kryeziu	The calculation of reinforced concrete elements under the action of bending moment, according to Eurocodes and US code ACI 318	<a href="mailto:i.kondi13@gmail.com">i.kondi13@gmail.com</a> ; <a href="mailto:igli.kondi@fin.edu.al">igli.kondi@fin.edu.al</a>
101	Dhurata Premti, Irakli Premti, Altina Tjegulla, Marisa Koci	Modelling and experimental evaluation of adhesion Strength in cement-based tile adhesives	<a href="mailto:dhurata.premti@fshn.edu.al">dhurata.premti@fshn.edu.al</a>
102	Enkeleda Kokona, Helidon Kokona, Ergys Caushi	A Sustainable Model for Heritage Property: Revitalizing a house in Berat Castle	<a href="mailto:enkeleda.kokona@fin.edu.al">enkeleda.kokona@fin.edu.al</a>

## Prania digjitale dhe pajisjet e komunikimit

Konferenca ICCE 2025 u mbështet nga faqja elektronike e dedikuar dhe zyrtare <https://icce.uni-pr.edu/>, e krijuar me qëllim që t'u ofrojë pjesëmarrësve të gjitha informacionet thelbësore në një format të qartë dhe të qasshëm. Platforma shërbeu si kanali kryesor i komunikimit për njoftimet e konferencës, regjistrimet, përditësimet e programit dhe informacionet rreth folësve kryesorë, duke siguruar koordinim të duhur dhe në kohë ndërmjet pjesëmarrësve dhe partnerëve.

U krijuan një baner profesional i konferencës dhe një identitet vizual për promovimin e ngjarjes në median digjitale dhe atë të shtypur, duke kontribuar në një brend të qëndrueshëm dhe rritje të dukshmërisë. Përveç kësaj, u zhvilluan disa mjete informuese dhe materiale digjitale—duke përfshirë ftesa elektronike, posterë dhe udhëzues virtual—të cilat lehtësuan orientimin, navigimin dhe pjesëmarrjen gjatë ditëve të konferencës.

Këto masa të komunikimit dhe të dukshmërisë e përmirësuan ndjeshëm organizimin e përgjithshëm të ICCE 2025, duke mbështetur shtrirjen efektive, angazhimin e pjesëmarrësve dhe njohjen ndërkombëtare të ngjarjes.



## Mbështetja Institucionale dhe Partnerët

Konferenca Ndërkombëtare në Inxhinierinë e Ndërtimit (ICCE 2025), e mbajtur në Prishtinë, Kosovë, u organizua nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit i Universitetit të

Prishtinës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës, me mbështetje të fuqishme institucionale nga partnerë akademikë dhe profesionalë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

ICCE 2025 u mbështet nga Subjektet si donatorët:



### **SKAT Consulting Ltd. – Infrastruktura e Qëndrueshme dhe Menaxhim i Ujërave**

Ndër partnerët e dalluar, SKAT Consulting Ltd. (Zvicër) kishte një rol të veçantë si mbështetës kyç institucional i ICCE 2025. Përmes përvojës së saj shumëvjeçare në zhvillimin e infrastrukturës, menaxhimin e integruar të burimeve ujore, përshtatjen klimatike dhe ngritjen e kapaciteteve, SKAT ka kontribuar ndjeshëm në forcimin e standardeve profesionale dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme inxhinierike në Kosovë dhe në rajonin më të gjerë.

Bashkëpunimi me SKAT Consulting reflekton përkushtimin e përbashkët për të lidhur kërkimin akademik me zbatimin praktik, duke mbështetur transferimin e dijes dhe fuqizimin e institucioneve lokale dhe inxhinierëve për të projektuar dhe menaxhuar sisteme infrastrukturore rezistente dhe të qëndrueshme.

**Vision Plus** është një kompani profesionale inxhinierike që specializohet në projektimin konstruktiv dhe arkitektonik, mbikëqyrjen dhe shërbimet konsulente në fushën e inxhinierisë së ndërtimit. Me një ekip inxhinierësh dhe dizajnerësh me përvojë, kompania ofron zgjidhje teknike cilësore që ndërthurin inovacionin, saktësinë dhe qëndrueshmërinë.

Vision Plus ofron një gamë të gjerë shërbimesh, duke përfshirë projektimin strukturor të ndërtesave prej betoni të armuar dhe çeliku, projektet infrastrukturore, zgjidhjet gjeoteknike dhe menaxhimin e projekteve. Kompania njihet për përkushtimin e saj ndaj ekselencës inxhinierike, respektimin e standardeve ndërkombëtare dhe përdorimin e teknologjive bashkëkohore të projektimit.

Si një partner institucional i vlerësuar i **ICCE 2025**, Vision Plus kontribuon në forcimin e lidhjes ndërmjet akademisë dhe industrisë së inxhinierisë, duke mbështetur avancimin e dijes praktike, zhvillimin profesional dhe zbatimin e praktikave të qëndrueshme të ndërtimit.

### **Euroing – Shërbime Inxhinierike, Projektim dhe Ndërtim**

Euroing është një kompani e konsoliduar e inxhinierisë dhe ndërtimit, e cila ofron shërbime të gjithanshme në fushat e projektimit strukturor, konsulencës së inxhinierisë së ndërtimit, menaxhimit të projekteve dhe mbikëqyrjes së ndërtimit. Ekipi i saj multidisiplinor i inxhinierëve dhe arkitektëve siguron zgjidhje teknike cilësore, të qëndrueshme dhe efikase, si për projektet publike ashtu edhe për ato private infrastrukturore.

Me një rekord të fortë të ekselencës profesionale, Euroing njihet për kontributin e saj në praktikatat moderne të projektimit, teknologjitë inovative të ndërtimit dhe respektimin e

standardeve ndërkombëtare inxhinierike. Projektet e saj reflektojnë një përkushtim të qartë ndaj sigurisë, funksionalitetit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Si partner institucional i **ICCE 2025**, Euroing luan një rol të rëndësishëm në afërimin e akademisë me praktikën profesionale, duke promovuar bashkëpunimin në kërkime, inovacion dhe ekselencë inxhinierike në të gjithë rajonin.

### **Ibër Lepenci – Ndërmarrje për Menaxhimin e Ujit dhe Infrastrukturës**

Ibër Lepenci është një ndërmarrje publike përgjegjëse për menaxhimin, operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit rajonal të furnizimit me ujë dhe infrastrukturës hidraulike në Kosovën qendrore dhe perëndimore. Ndërmarrja luan një rol kyç në sigurimin e menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve ujore, duke i shërbyer sektorëve komunalë dhe industrialë, përfshirë prodhimin e energjisë, bujqësinë dhe zhvillimin urban.

Përmes modernizimit të vazhdueshëm dhe investimeve në infrastrukturën hidraulike dhe mjedisore, Ibër Lepenci kontribuon në përmirësimin e sigurisë ujore, rritjen e qëndrueshmërisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit. Ndërmarrja bashkëpunon ngushtë me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për të promovuar përdorimin efikas të burimeve natyrore dhe integrimin e standardeve bashkëkohore inxhinierike dhe mjedisore.

Si mbështetës institucional i **ICCE 2025**, Ibër Lepenci sjell ekspertizë të vlefshme në inxhinierinë ujore, menaxhimin e burimeve dhe zhvillimin e infrastrukturës së qëndrueshme, duke forcuar lidhjen ndërmjet praktikës, kërkimit dhe edukimit në inxhinierinë civile dhe mjedisore.

### **Proing – Shërbime të Inxhinierisë Civile dhe Konsulencë Teknike**

Proing është një kompani profesionale e specializuar në projektim inxhinierik, mbikëqyrje dhe shërbime konsulente në fushën e inxhinierisë së Ndërtimit dhe strukturave. Me përvojë të gjerë në projekte infrastrukturore dhe të ndërtimit, Proing ofron zgjidhje të gjithanshme që mbulojnë projektimin strukturor, menaxhimin e projekteve, studimet gjeoteknike dhe mbikëqyrjen e ndërtimit, duke siguruar përputhshmëri me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Kompania njihet për ekselencën teknike, besueshmërinë dhe përkushtimin e saj ndaj praktikave të qëndrueshme inxhinierike, duke ofruar qasje inovative që integrojnë funksionalitetin, sigurinë dhe efikasitetin në çdo projekt.

Si partner institucional i **ICCE 2025**, Proing mbështet avancimin e dijes inxhinierike dhe kontribuon në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet akademisë dhe industrisë së ndërtimit, duke promovuar zhvillimin profesional dhe zbatimin e parimeve moderne e të qëndrueshme të projektimit.

ICCE 2025 me krenari u mbështet edhe nga:

- **Instituti i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, UP.**
- **Gdańsk University of Technology, Poland**
- **University of Life Sciences in Lublin, Poland**
- **Poznan University of Technology, Poland**
- **Ss. Cyril and Methodius University in Skopje, Faculty of Civil Engineering (FCE UKIM)**

- **Institute of Earthquake Engineering and Engineering Seismology (IZIIS), Skopje**

Këto partneritete pasqyrojnë karakterin e fuqishëm ndërkombëtar të konferencës dhe përkushtimin e saj për të nxitur bashkëpunimin ndërmjet universiteteve, instituteve kërkimore dhe organizatave profesionale në Evropë dhe më gjerë.

Falë mbështetjes së përbashkët të këtyre institucioneve, ICCE 2025 vazhdon të shërbejë si një platformë për avancimin e dialogut shkencor, promovimin e praktikave të qëndrueshme inxhinierike dhe inkurajimin e shkëmbimit të dijes dhe inovacionit në fushën e inxhinierisë civile dhe strukturore.

### **Aktivitetet gjatë Konferencës**

Përmbledhje e Konferencës Ndërkombëtare në Inxhinierinë e Ndërtimit (ICCE 2025)

Datat: 15–18 Tetor 2025

Vendi: Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti i Prishtinës, Kosovë

Konferenca e 3-të Ndërkombëtare në Inxhinierinë e Ndërtimit (ICCE 2025) bashkoi akademikë të njohur, hulumtues, profesionistë dhe studentë nga më shumë se 20 vende, nën temën e inovacionit, qëndrueshmërisë dhe reziliencës në inxhinierinë civile. Gjatë tre ditëve me sesione shkencore, kumtesa kryesore dhe diskutime teknike, konferenca ofroi një platformë dinamike për shkëmbimin e njohurive dhe përvojave në të gjitha fushat e inxhinierisë civile dhe mjedisore.

Dita 1 – 15 Tetor 2025: Mirëseardhja dhe Kumtesat Kryesore

Konferenca filloi në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti i Prishtinës, me regjistrimin dhe fjalët hyrëse nga Prof. Florim Grajçevci dhe Prof. Neritan Shkodrani.

Pasditja vazhdoi me katër kumtesa kryesore me nivel të lartë shkencor:

- Prof. Jason Harris (SHBA) – *Siguria dhe mbrojtja bërthamore në reaktorët modularë të avancuar.*
- Prof. José António Campos Matos (Portugali) – *Qasje inovative për menaxhimin e qëndrueshëm të infrastrukturave ekzistuese.*
- Prof. Theodore S. Karacostas (Greqi) – *Zbutja e thatësirës në kontekstin e ndryshimeve klimatike përmes rritjes së reshjeve.*
- Prof. Vlado Spiridonov (Maqedonia e Veriut) – *Sisteme më të zgjuara për parashikimin e motit ekstrem dhe alarmimin.*

Dita u mbyll me një koktej mirëseardhjeje në International Corner të FIN, nën shoqërimin e muzikës live nga saksofonisti Dukagjin Muhaxheri, duke krijuar një atmosferë të këndshme rrjetëzimi.

Dita 2 – 16 Tetor 2025: Ceremonia Zyrtare dhe Sesionet Tematike

Dita e dytë filloi me Ceremoninë Zyrtare të Hapjes, të kryesuar nga Prof. Florim Grajçevci, Prof. Neritan Shkodrani, Prof. Akli Fundo dhe Prof. Avni Hajdari.

Pasuan një sërë kumtesash ndërkombëtare nga folës të fushave të ndryshme:

- Prof. Günter Langergraber (Austri) – *Kënetat e trajtimit në menaxhimin rural të ujërave të ndotura.*
- Prof. Bujar Morava (SHBA) – *Sistemet shitesë të disipimit në ndërtesat e larta.*
- Prof. Klaus Holschemacher (Gjermani) – *Prodhimi i automatizuar i elementeve të parapërgatitura me përforcim karboni.*
- Prof. Alexandros Stefanakis (Greqi) – *Kënetat e ndërtuara për menaxhim rrethor të ujërave të ndotura.*
- Prof. Georg Gartner (Austri) – *Rëndësia e kartografisë dhe inteligjencës artificiale.*
- Prof. Dashnor Hoxha (Francë) – *Projektimi i punimeve nëntokësore në kushte termo–hidro–mekanike.*
- Prof. Krzysztof Józwiakowski (Poloni) – *30 vite përvojë në impiantet me kënete të ndërtuara.*
- Prof. Iman Hajirsouliha (MB) – *Optimizim i bazuar në performancë për sistemet e çelikut të formuar në të ftohtë.*
- Prof. Klaudia Anna Borowiak (Poloni) – *Elementet e tokës së rrallë në mjedisin urban.*
- Prof. Hakim S. Abdelgader (Libi) – *Llaçi dhe betoni vetëkompaktues.*

Dita përfundoi me Darkën festive të mbajtur në Hotel Venus, duke festuar bashkëpunimin dhe ekselencën akademike.

Dita 3 – 17 Tetor 2025: Inxhinieri Sizmike dhe Sesione Paralele

Dita e tretë u hap me sesione të fokusuar në inxhinierinë sizmike dhe qëndrueshmërinë strukturore, me tre kumtesa të shquara:

- Prof. Alper Ilki (Turqi) – *Fragjiliteti sizmik i ndërtesave banesore prej BA, bazuar në tërmetet e Turqisë 2023.*
- Prof. Abdulkadir Cüneyt Aydın (Turqi) – *Korrja e energjisë nga tërmetet dhe sistemet e izolimit sizmik.*
- Prof. Mehmet Salih Bayraktutan (Turqi) – *Rrëshqitjet e tokës dhe rrjedhat e baltës të shkaktuara nga aktiviteti sizmik në Turqinë lindore.*

Pas sesionit plenar, u zhvilluan tre sesione teknike paralele (në sallat 408, 414 dhe 415), ku u prezantuan punime kërkimore nga fusha e strukturave, mjedisit, gjeoteknikës, hidroteknikës dhe inxhinierisë së transportit.

Kafepushimet, sesionet e rrjetëzimit dhe dreka e përbashkët mundësuan shkëmbime të vlefshme profesionale.

Ngjarja u përmbyll me Ceremoninë e Mbylljes, ku organizatorët shprehën mirënjohje për të gjithë folësit, kontribuuesit dhe partnerët institucionalë, duke riafirmuar angazhimin për të forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe për t'u përgatitur për ICCE 2026.

Dita 4 – 18 Tetor 2025: Vizita Studimore dhe Rrjetëzim

Dita e fundit iu dedikua vizitave studimore dhe aktiviteteve të rrjetëzimit, ku pjesëmarrësit vizituan projekte infrastrukturore dhe pika kulturore në Prishtinë dhe rrethinë.

## Ndikimi i Përgjithshëm

ICCE 2025 kombinoi me sukses ekselencën shkencore, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe lidhjen midis akademisë dhe industrisë, duke adresuar sfidat bashkëkohore në inxhinierinë civile dhe mjedisore.

Pjesëmarrja e mbi 17 folësve kryesorë dhe dhjetëra partnerëve institucionalë — universitete, institute kërkimore, ndërmarrje publike dhe kompani inxhinierike — e theksoi rolin në rritje të Kosovës si qendër rajonale për kërkimin dhe inovacionin inxhinierik.

## Rekomandime për Edicionet e Ardhshme

Duke u mbështetur në përvojën dhe rezultatet e ICCE 2025, si dhe në komentet e vlefshme të ofruara nga pjesëmarrësit, për edicionet e ardhshme të konferencës rekomandohen disa drejtime lidhur me zhvillimin dhe eventualisht përmirësimin.

Konferencat e ardhshme të ICCE duhet të synojnë forcimin e bashkëpunimit midis akademisë, industrisë dhe institucioneve publike, duke krijuar një lidhje më të ngushtë ndërmjet kërkimit shkencor dhe zbatimit praktik në fushën e inxhinierisë civile dhe mjedisore. Krijimi i partneriteteve më të forta me kompani projektimi dhe ndërtimi, studio inxhinierike dhe agjenci qeveritare do të rrisë rëndësinë e konferencës dhe do të kontribuojë në rezultate të orientuara drejt inovacionit.

Edicionet e ardhshme inkurajohen të përfshijnë një gamë më të gjerë sesionesh tematike dhe punëtorish interaktive që trajtojnë tema në zhvillim, si inteligjenca artificiale në inxhinieri, infrastruktura e zgjuar, materialet e qëndrueshme dhe projektimi i rezistueshëm ndaj klimës. Rritja e pjesëmarrjes ndërkombëtare përmes sesioneve të përbashkëta, mbështetjes së mobiliteteve dhe partneriteteve me universitete dhe institute kërkimore evropiane do të rrisë më tej cilësinë akademike dhe dukshmërinë globale të serisë ICCE.

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet angazhimit të studentëve dhe hulumtuesve të rinj, duke krijuar një platformë të dedikuar brenda konferencës për prezantimin e punës së tyre, mentorim dhe çmime për kontributet shkencore dhe inovative më të spikatura. Në të njëjtën kohë, organizimi i edicioneve të ardhshme duhet të vazhdojë të përqafojë transformimin digjital, duke ofruar formate hibride që mundësojnë pjesëmarrje fizike dhe virtuale, duke siguruar kështu qasje më të gjerë dhe përhapje më të madhe të dijes.

Strategjia e publikimeve të ICCE duhet të forcohet përmes zhvillimit të bashkëpunimeve me revista ndërkombëtare të indeksuara dhe platforma me qasje të hapur, duke mundësuar shpërndarje më të gjerë dhe njohje më të madhe të kërkimeve të prezantuara. Gjithashtu, adoptimi i praktikave të qëndrueshme në menaxhimin e ngjarjeve — si regjistrimi pa letër, reduktimi i printimeve, iniciativat e riciklimit dhe përdorimi i burimeve lokale — do të reflektojë përgjegjësinë mjedisore dhe vlerat bazë të konferencës.











Së fundi, rekomandohet krijimi i një komiteti të përhershëm shkencor dhe organizativ për të siguruar vazhdimësi dhe planifikim strategjik midis edicioneve të konferencës. Kjo do të ndihmojë në lidhjen e temave të konferencës me prioritetet kërkimore rajonale dhe evropiane, ruajtjen e kujtesës institucionale dhe mbështetjen e vizionit afatgjatë të ICCE si një platformë kryesore shkencore në Ballkan dhe më gjerë.

## Përfundim

ICCE 2025 u përmbyll me sukses të madh, duke riafirmuar përkushtimin e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit për të qenë një qendër e ekselencës akademike dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

## Falënderime për Sekretariatit e Konferencës

Komiteti Organizativ i ICCE 2025 shpreh mirënjohjen më të thellë ndaj Sekretariatit të Konferencës për përkushtimin e jashtëzakonshëm, profesionalizmin dhe efikasitetin e treguar në të gjitha fazat e përgatitjes dhe realizimit të konferencës.

 Almedina Rapuca	 Labeat Misini	 Hana Shehu Agani	 Ilir Canaj
 Anita Gjukaj	 Venera Hajdari Llapashtica	 Zijadin Guri	 Joana Gjipalaj
 Santino Spahiu	 Drilona Disha		

Sekretariati luajti një rol thelbësor në koordinimin e komunikimit me pjesëmarrësit, menaxhimin e regjistrimeve, përgatitjen e materialeve të konferencës dhe sigurimin e zhvillimit të pandërprerë të të gjitha sesioneve dhe aktiviteteve. Përpjekjet e tyre të palodhshme, si para ashtu edhe gjatë ditëve të konferencës, kontribuan ndjeshëm në suksesin e ICCE 2025.

Mirënjohje e veçantë u shprehet Vlerë Krasniqit për moderimin e ICCE 2025, Qëndresë Berishës, Lulzim Hajdinit dhe Altin Mujajt për mbështetjen e tyre profesionale, koordinimin dhe pjesëmarrjen në sesione të ndryshme dhe aktivitete organizative. Përkushtimi i tyre, puna ekipore dhe ekselencia akademike luajtën një rol kyç në mbarëvajtjen dhe suksesin e përgjithshëm të konferencës.

Kontributi i tyre në asistimin e mysafirëve ndërkombëtarë, moderimin e sesioneve dhe mbështetjen e organizimit shkencor e logjistik të ICCE 2025 pasqyron frymën e fortë të bashkëpunimit dhe përkushtimit që e karakterizon Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit.

Falënderime të veçanta u shprehen gjithashtu të gjithë stafit administrativ, asistentëve teknikë dhe vullnetarëve nga radhët e studentëve të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit të Universitetit të Prishtinës, të cilët me angazhimin, bashkëpunimin dhe mikpritjen e tyre krijuan një përvojë të jashtëzakonshme për të gjithë mysafirët dhe delegatët e konferencës.

Komiteti Organizativ e vlerëson thellësisht kontributin e tyre dhe pranon se suksesi i ICCE 2025 nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen e tyre të vazhdueshme dhe entuziazmin profesional.

Përgaditur nga:

Prof. Dr. Florim Grajçevci, Dekan, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit

Universiteti i Prishtinës

Dhjetor 2025